

**TABELA E PËRPUTHSHMËRISË
PËR
PROJEKT-LIGJIN “PËR CENSIN E POPULLSISË DHE BANESAVE”**

Bazuar ne VKM nr.584 dt 28.08.2003, i ndryshuar “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, ku kërkohet që çdo projektligj të shoqërohet me “vlerësimin e shkallës së përputhshmërisë së ligjit me *Acquis Communautaire*”

1. Rregullorja (KE) Nr. 763/2008 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, 9 Prill 2008, për censet e popullsisë dhe banesave, (FZ L 218/14, 13.08.2008). CELEX number: 3A32008R0763		Projekt-ligj “Për censin e popullsisë dhe banesave”				
		Përputhshmëri e pjesshme				
1	2	3	4	5	6	7
		Referenca	Neni	Teksti	Përputhshmëria	Shënime
<i>Rregullorja (KE) Nr. 763/2008</i>						
Neni 2	Përkufizime Për qëllimet e kësaj Rregullore, do të zbatohen përkufizimet si vijon: (a) “Popullsia” do të kuptohet popullsia në nivel kombëtar, rajonale dhe lokal në vendbanimin e saj të zakonshëm në datën referuese; (b) “Strehim” do të thotë zona banimi dhe ndërtesa banimi, si dhe përshtatjet për strehim dhe marrëdhënia ndërmjet popullsisë dhe zonave të banimit në nivele kombëtare, rajonale dhe locale në datën referencë; (c) “Ndërtesë” do të kuptohet struktura të përhershme që përmbajnë hapësira jetese të projektuara për banim njerëzor, ose banesa konvencionale të rezervuara për qëllime sezonale apo dytësore, ose që janë të lira; (d) “Vendbanim i zakonshëm” është vendi ku personi zakonisht kalon periudhën e përditshme të pushimit, pavarësisht nga mungesa të përkohshme për qëllime rekreative, pushime, vizita në miq dhe të afërm, biznes, trajtim mjekësor ose pelegrinazhi fetar. Personat që konsiderohen si vendbanues të zakonshëm të një zone gjeografike janë: (i) ata që kanë jetuar në vendbanimin e tyre të zakonshëm për një periudhë të vazhdueshme të paktën 12 muaj para datës referuese; ose (ii) ata që kanë ardhur në vendbanimin e tyre të zakonshëm gjatë 12 muajve para datës së referencës me qëllim që të qëndrojnë aty për të paktën një vit. Kur rrethanat e përshkruara në pikat (i) ose (ii) nuk mundën të përcaktohen, ‘vendbanimi i zakonshëm’ do të thotë vendi i ligjshëm ose vendbanimi i regjistruar. (e) “datë referuese” do të kuptohet data në të cilën referohen të dhënat e Shtetit Anëtar përkatës, në përputhje me Nenin 5 (1); (f) “kombëtar” do të kuptohet territori një Shteti Anëtar; (g) “rajonale” do të kuptohet niveli NUTS 1, niveli NUTS 2 ose niveli NUTS 3, siç përcaktohet në klasifikimin e njësive territorial statistikore (NUTS), të përcaktuara nga Rregullorja (KE) Nr. 1059/2003 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit në varianin e zbatueshëm në datën referuese; (h) “lokal” do të kuptohet niveli 2 i njësive administrative locale (niveli LAU 2); (i) “tiparet thelbësore të censit të popullsisë dhe banesave” do të kuptohet numërimi individual, simlutaniteti, universaliteti brenda një territori të përcaktuar, disponueshmëria e të dhënave të zonës së vogël dhe periodiciteti i përcaktuar.		3	Përkufizime Në kuptim të këtij ligji termat e mëposhtme do të kuptohen kështu: a) “Popullsia” do të thotë popullsia në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor, e cila gjendet në vendbanimin e zakonshëm në momentin e Censit. b) “Ndërtesë” nënkupton një strukturë të përhershme që përmban banesa të zakonshme të projektuara për banim njerëzor ose që janë të rezervuara për banim sezonal apo dytësor, ose që janë boshe. c) “Banesë” do të thotë një vend i veçantë dhe i pavarur i vendbanimit ose i menduar për banim nga njësitë ekonomike familjare, pavarësisht nëse është e zënë ose jo në momentin e Censit, ose nëse nuk është menduar për banim, por është përdorur si vendbanim në momentin e Censit. ç) “Vendbanim i zakonshëm” është vendi ku personi zakonisht kalon periudhën e përditshme të pushimit, pavarësisht nga mungesa të përkohshme për qëllime rekreative, pushime, vizita në miq dhe të afërm, biznes, trajtim mjekësor ose pelegrinazhi fetar. Personat që konsiderohen si vendbanues të zakonshëm të një zone gjeografike janë: (i) ata që kanë jetuar në vendbanimin e tyre të zakonshëm për një periudhë të vazhdueshme të paktën 12 muaj para datës referuese; ose (ii) ata që kanë ardhur në vendbanimin e tyre të zakonshëm gjatë 12 muajve para datës referuese me qëllim që të qëndrojnë aty për të paktën një vit. Kur rrethanat e përshkruara në pikat (i) ose (ii) nuk mundën të përcaktohen, ‘vendbanimi i zakonshëm’ do të thotë vendi i ligjshëm ose vendbanimi i regjistruar. d) “Njësia Ekonomike Familjare (NjEF)” kuptohet një person i cili jeton vetëm, ose një grup personash të cilët jetojnë bashkë, në një pjesë ose në të gjithë banesën, dhe të cilët ndajnë ushqimin dhe gjëra të tjera të domosdodhme për të jetuar. e) “Cens” është mbledhja e informacionit me anë të pyetësorëve dhe përpunimi i të dhënave të tilla, në mënyrë që të sigurojë një numërim të plotë të të gjithë individëve, njësive ekonomike familjare e banesave dhe të ndërtesave të shfrytëzuara për qëllime banimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në një moment të vetëm në kohë, si dhe prodhimi i statistikave në lidhje me karakteristikat demografike, ekonomike dhe sociale të popullsisë së Shqipërisë. ë) “Dita e Censit” është dita e parë e fillimit të mbledhjes së të dhënave në terren. f) “Momenti i Censit” është ora 00:00 e mesnatës, që paraprin ditën e Censit. g) “Mbledhja e të dhënave” nënkupton procesin e mbledhjes së informacionit të Censit në lidhje me një territor të caktuar për një periudhë të caktuar kohore nëpërmjet intervistave të kryera nga stafi i terrenit dhe të kryera nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve për secilën ndërtesë, vendbanim, njësi ekonomike familjare dhe individ në atë territor.	pjesërisht	

			gj) “Periudha e mbledhjes së të dhënave” do të thotë periudha kohore gjatë së cilës të dhënat mund të mbledhen nga publiku nëpërmjet stafit të terrenit të Censit. h) “INSTAT” kupton Institutin e Statistikave të Shqipërisë dhe është autoriteti ekzekutiv përgjegjës për planifikimin, zbatimin dhe menaxhimin e Censit. i) “Të dhëna personale” kupton çdo lloj informacioni të parashikuar në legjislationin për mbrojtjen e të dhënave personale. j) “Refuzim” do të thotë mospranimi ose kundërshtimi i personave të përcaktuar në pikën 1 të nenit 4 të këtij ligji për dhënien e informacionit të kërkuar në pyetësorët e Censit.		
--	--	--	--	--	--

**TABELA E PËRPUTHSHMËRISË
PËR
PROJEKT-LIGJIN “PËR CENSIN E POPULLSISË DHE BANESAVE”**

Bazuar ne VKM nr.584 dt 28.08.2003, i ndryshuar “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, ku kërkohet që çdo projektligj të shoqërohet me “vlerësimin e shkallës së përputhshmërisë së ligjit me *Acquis Communautaire*”

Rregullorja Zbatuese (KE) Nr. 2017/543 e Komisionit, 22 Mars 2017, për caktimin e rregullave për zbatimin e Rregullores (KE) Nr. 763/2008 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit për censet e popullsisë dhe banesave, përta i takon specifikimeve teknike të (FZ L 78/13, 23.03.2017). CELEX number: 3A32011R0543		Projekt-ligj “Për censin e popullsisë dhe banesave”				
		Përputhshmëri e pjesshme				
1	2	3	4	5	6	7
		Referenca	Neni	Teksti	Përputhshmëria	Shënime
Aneksi Specifiki met teknike për temat dhe nëntemat e censit që duhet të zbatohen në të dhënat që i dërgohen Komision it për vitin e references 2021, janë të parashiku ara në Aneks	Specifikimet teknike për temat dhe nëntemat e censit Tema: Strehimi “Banesat kolektive” nënkuptojnë mjediset që janë të projektuara për banim të përbashkët nga grupe individësh ose disa njësi ekonomike familjare dhe që përdoren si vendbanim i zakonshëm nga të paktën një person në momentin e Censit.		3	dh) “Banesat kolektive” nënkuptojnë mjediset që janë të projektuara për banim të përbashkët nga grupe individësh ose disa njësi ekonomike familjare dhe që përdoren si vendbanim i zakonshëm nga të paktën një person në momentin e Censit.	pjesërisht	